



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1585 / prot.
4

Tiranë më 21.10.2022

VENDIM

Nr. 30, datë 21.10.2022

PËR KONTROLLUESIN “SANARIX SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Sanarix SHPK.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 156, datë 21.09.2022, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit nga kontrolluesi “Sanarix SHPK”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi me NUIS L92420009B, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila kryen veprimtarinë për ofrimin e ndihmës përfshirë infermierinë, kujdesin në shtëpi, shtrimin në spital dhe objektet e tjera të banimit për t'u realizuar me personelin e tyre të kualifikuar dhe jo të kualifikuar. Kryerjen e shërbimeve shëndetësore, infermiore dhe e kujdesit, si vetë, ashtu edhe në marrëveshje me organet publike dhe private. Objekti kryesor i shoqërisë është aktiviteti në sektorët merceologjik, farmaceutik,

erboristeri, parukeri-estetikë, trajtime trupi dhe fytyre, kërkim-zhvillim, kurse profesionale. Shoqëria kryen çdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “vizitorë”, “nëpunës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me mbikëqyrjen e zyrave nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), kamerat e të cilit regjistronin edhe zërin (audio) të personave prezent, është konstatuar se kamerat janë hequr nga ambientet e brendshme (zyra dhe korridorit) dhe njësia qendrore e sistemit (CCTV) e tipit “EZVIZ Smart Home Camera Base Station, Model: CS-Ë2H”, ishte jo-aktive (e çmontuar) dhe e vendosur mbi tavolinë, në zyrën e nëpunësve.

Referuar provave të administruara, rezulton se Kontrolluesi ka pasur të instaluar dhe në funksionim sistemin e video-survejjimit (CCTV), për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-survejjimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme si “imazhe”, “video” dhe “zëri/audio”, janë të dhëna personale, dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesit.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

4. Kontrolluesi ka lidhur kontratë me personin fizik/individ “F.K.”, më datën 01.09.2022, me objekt, ndër të tjera, “... konsulencë kontabël, ... ndjekjen e procedurave e plotësimit si dhe deklarime të ndryshme, listë pagesa, deklarimin dhe largimin e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim-fitimin, etj.”.

Konstatohet se kontrata nuk parashikon detyrimet e parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012, mbi *“Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin i cili pasi u lexua, u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i Kontrolluesit nuk paraqiti komente.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Njoftimi për zhvillimin e seancës dëgjimore është kryer fillimisht nëpërmjet postës zyrtare, në adresë të objektit të aktivitetit pranë të cilit u ushtrua hetimi administrativ. Në kushtet që komunikimi nuk është mundur të realizohet fizikisht, një kopje elektronike e njoftimit të zhvillimit të seancës dëgjimore, i është dërguar administratorit të shoqërisë në postën elektronike personale, të vendosur në dispozicion, gjatë zhvillimit të hetimit. Megjithatë, në datën dhe orën e caktuar, pranë Zyrës së Komisionerit nuk është paraqitur asnjë përfaqësues i Kontrolluesit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, pika 1, germat *“a”*, *“ç”* dhe *“d”* të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

ç) kontrolluesit, ose përpunuesi që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysht faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm

të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 20, 21, 29, 30, 39 (pika 1, germet "a", "ç", "d", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
4. Kontrolluesi të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat "video/audio" e mbledhura për subjektet e të dhënave "punonjës", të cilat janë përpunuar nëpërmjet sistemit CCTV, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
5. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të përmbushë detyrimin për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, pranë Zyrës së Komisionerit.
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 4 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër.
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;
8. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 21. 10. 2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

